

Raporti për Arritjet në 2017



*Empowered lives.
Resilient nations.*





Të dashur lexues

Është kënaqësi të shkruaj këtë editorial vetëm dy javë pas mbërritjes time në Kosovë si Përfaqësuese e Përhershme e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Koordinatorës së OKB-së për Zhvillim në Kosovë.

Derisa shfletoni këto faqe, ndihem krenare që jam pjesë e ekipit të UNDP-së në Kosovë, i cili së bashku me partnerëve tonë të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë agjencitë si-motra të OKB-së, në nivel qendror dhe lokal, ka arritur rezultate kaq të rëndësishme dhe shpesh transformuese gjatë vitit 2017. Nga krijimi i vendeve të punës, deri te biznes grantet për grupet e cenuara, të rinjtë dhe gratë, deri tek riintegrimi i të riatdhesuarve dhe njerëzve që jetojnë në zona të largëta ... Nga mbështetja në sektorët e drejtësisë dhe sigurisë deri tek luftimi i korrupsionit dhe ndërtimi i urave ndërmjet komuniteteve përmes trashëgimisë së përbashkët kulturore ... dhe nga puna me komunitete për të rritur ndërgjegjësimin dhe ripërtëritjen për zvogëlimin e rreziqeve që lidhen me fatkeqësitë mjedisore si pjesë e iniciativave më të gjera rajonale. Siç do të shihni, shumë është arritë!

Ne publikuam botime për të forcuar parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Ne gjithashtu kemi vazhduar publikimin e anketës tonë “Pulsi publik” për të mësuar rreth perceptimit të publikut dhe nivelit të kënaqëshmërisë me çështjet më urgjente me të cilat përballet populli në Kosovë.

Gjatë tërë punës sonë, ne nxorrëm në pah agjendën për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe zyra jonë në Kosovë është njëra nga 31 zyrat krenare të UNDP-së në mbarë botën që u nderua me Vulën e Argjendit të Barazisë Gjinore.

E gjithë puna, suksesi, arrijtet tona nuk do të ishin të mundura pa bashkëpunimin e fuqishëm me partnerët dhe donatorët tanë. Ju shpreh mirënjohje të ngrohtë të gjithë juve! Do të përkushtohem dhe angazhohem, së bashku me ekipin tim, të mbështes dhe të shoqëroj partnerët për ta bërë Kosovën një vend më të mirë për popullin e saj. Shpresoj që të arriturat e ardhshme do t'i festojmë së bashku.

Ulrika Richardson
Përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së

UNDP në Kosovë dëshiron të falenderojë të gjithë partnerët dhe donatorët, posaçërisht:

Zyrën Kryeministrit të Kosovës

Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë / KIESA

Komunën e Vitisë

Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Komunën e Dragashit

Ministrinë e Punëve të Brendshme

Komunën e Shtërpcës

Bashkimin Evropian

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Mbretërinë e Bashkuar

Japoninë

Zvicrën

Austrinë

Suedinë

Gjermaninë

Danimarkën

Italinë

Luksemburgun

Norvegjinë

Raporti për Arritjet në 2017



Janë krijuar mbi
16 mijë vende pune
gjatë **10 viteve** të
fundit

Barazia Gjinore

UNDP në Kosovë është njëra nga 31 zyrat e UNDP-së në mbarë botën që është vlerësuar për arritjen e rezultateve transformuese të barazisë gjinore dhe ka fituar Vulën e Argjendtë për Barazi Gjinore të UNDP-së



Krijimi i vendeve të punës dhe zhvillimi i shkathtësive

564

546 vende pune gjatë vitit 2017 për qytetarë të papunë në afat të gjatë me shkathtësi të ulëta, gra, të rinj, komunitetet joshumicë, të kthyerit e riadhesuar dhe personat e tjerë në rrezik nga përjashtimi socio-ekonomik, 51% prej tyre gra

3700

U përmirësuan jetët e më shumë se 3700 personave

51%
gra



Janë krijuar mbi 16 mijë vende pune gjatë 10 viteve të fundit



Përmirësimet e shërbimit publik dhe përkrahja e politikave


U ndihmua ngritja dhe funksionalizimi i Agjencisë së re të Punësimit

.....

Shërbimet publike të punësimit u pajisën me mjete për të ofruar shërbime më të mira, më të shpejta dhe më të sakta për punëkërkuarit



Ri-integrimi i qëndrueshëm i kosovarëve të riatdhesuar



- U zhvilluan Strategjia për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2018-2022 dhe plani i veprimit që drejton zbatimin e saj për periudhën 2018-2020

Zhvillimi ekonomik lokal dhe rural

270

Mbi 270 persona (48% gra) të trajtuar drejtpërdrejt gjatë vitit 2017 përmes 4 Pakteve të Punësimit Territorial që stimulojnë zhvillimin gjithë-përfshirës ekonomik lokal dhe krijimin e vendeve të punës gjatë sezonit të punëve bujqësore

51

Është përmirësuar produktiviteti, të hyrat, si dhe janë krijuar vende të reja pune në 51 mikro dhe biznese të vogla

.....

48%

gra

“Punë të gjelbra” përmes ndërmarrësisë sociale: 3 ndërmarrje sociale të integritit të punës në veprim, me 60 mundësi të reja pune gjatë vitit 2017

Përkrahja e sektorit privat

380

Mbi 380 kompani përfituan nga punonjësit e rinj përmes programeve të tregut aktiv të punës

200

Më shumë se 200 biznese përfituan nga rrjetëzimi i bizneseve dhe promovimi i produkteve



Investimet u promovuan përmes komunikimit më të mirë publik dhe dukshmërisë së mundësive për investime, me 39 mjete dhe kanale të reja të komunikimit të KIESA-së të zhvilluara dhe përditësuara



Bashkëpunimi i shoqërisë civile në nivel lokal



Vazhdojnë përpjekjet rajonale për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve përmes organizatave të shoqërisë civile dhe bashkëpunimit komunal në 5 komuna në Kosovë.

Qeverisja Demokratike dhe Ndërtimi i Paqes

Sundimi i Ligjit dhe Qasja në Drejtësi

6,391 

Numri i lëndëve të pa zgjidhura të Gjykatës Themelore u zvogëlua me 6,391 lëndë, ose 53% të shkallës së përgjithshme të zgjidhjes së lëndëve të gjykatës për vitin 2017, ndërsa në gjykatën e shkallës së dytë u zvogëluan me 1,058 lëndë, ose 10% të shkallës së përgjithshme të zgjidhjes së lëndëve të gjykatës për vitin 2017. U zhvillua një politikë e koordinuar e trajnimit për personelin gjyqësor duke përkrahur zhvillimin e kapaciteteve profesionale

Fushata e ndërgjegjësimit për ndihmën juridike e transmetuar në stacionet televizive lokale dhe mediat sociale arriti

200,000 persona

U hartuan planet e veprimit për trajtimin e dhunës në familje në **4 komunitat veriore**

36 

36 gjyqtarë dhe prokurorë tani janë në gjendje të zbatojnë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe kanë njohuri për jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë

792

792 persona zgjidhën mosmarrëveshjet e tyre (45% gra dhe 55% burra) përmes ndërmjetësimit, duke përmirësuar kështu qasjen e personave në drejtësi

3,288

3,288 persona, 1,619 gra dhe 1,762 burra përfituan nga shërbimet e ndihmës juridike, një rritje prej 8% nga viti 2016. 443 përfitues ishin nga grupet e pakicave

Siguria në Kosovë

Sistemi i Armëve të Zjarrit (SAZ) në Kosovë është i vetmi, në mbarë botën, që ka qasje në informimin automatik nga të gjitha sistemet që përmbajnë inteligjencë ballistike dhe kriminalistike. SAZ u prezantua si praktikë më e mirë rajonale në Simpoziumin Forenzik të Armëve të Zjarrit të Interpol-it

Ministria e Punëve të Brendshme publikoi raportin e dytë të anketës së opinionit publik për radikalizimin në nivel komuniteti, me mbështetjen e UNDP-së (608 të intervistuar dhe intervista në grupe fokusi)

U përmirësua siguria në komunitet dhe sundimi i ligjit përmes hartimit të planeve për siguri në komunitet, dhe auditimit të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe auditimit të krimit, duke përfshirë pajisjen e 5 komunave me mbikëqyrje CCTV, që kontribuon në zgjidhjen e rasteve të kriminalitetit në rrugë

Raporti i anketës së parë me 13 luftëtarë të huaj të dënuar, dhe familjet e tyre, për t'i identifikuar arsyet që shtynë kosovarët të përfshiheshin në luftërat e huaja

U pilotua Mekanizmi i Referimit në komunën e Gjilanit, i pari i këtij lloji në Kosovë dhe në rajon

1,394

1,394 armë ilegale janë konfiskuar, dhe 60,000 janë shënuar për shkatërrim



Përprojekjet kundër korrupsionit

#1

U zhvillua treguesi i parë i transparencës, duke renditur nivelet e transparencës së buxhetit të komunave

25

U hartuan 25 plane integriteti për institucionet e Kosovës; 1,958 raste të korrupsionit janë raportuara nga qytetarët ndërsa 1,213 raste janë shqyrtuar dhe përfunduar

50

50 zyrtarë të policisë, prokurorisë, tatimeve, doganave dhe të inteligjencës financiare i kanë zhvilluar aftësite për hetime financiare për të identifikuar skemat e korrupsionit dhe për të konfiskuar të ardhurat e paligjshme, si pjesëmarrës në program të çertifikuar njëvjeçar


50 zyrtarë të policisë, prokurorisë, tatimeve, doganave dhe të inteligjencës financiare janë trajnuar për hetimin dhe ndjekjen penale të mashtrimit tatimor dhe evazionit fiskal

Personat e pagjetur

U lehtësua dialogu mes organizatave të personave të pagjetur të Kosovës dhe Serbisë

992

Additional
Ante mortem



2 mjekë nga Instituti për Mjekësi Ligjore janë trajnuar për antropologji forenzike sipas standardeve të BE-së

Databaza e të dhënave ante mortem /post mortem tani ka 1,800 raste të tjera të regjistruara

Krijimi i Besimit përmes Mbrojtjes të Trashëgimisë Kulturore në Kosovë



18

U rehabilituan ose u rindërtuan 18 objekte të trashëgimisë kulturore dhe fetare, në 5 komunitet multi-etnike të Kamenicës, Lipjanit, Ferizajit, Gjilanit, Rahovecit

7

7 punëtorë për Ri-imagjinimin e Trashëgimisë Kulturore angazhuan 152 të rinj për të hartuar zgjidhje të reja për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore

5

5 Sesione Edukative angazhuan 190 nxënës të shkollave të mesme dhe 15 mësues nga 18 shkolla për të përfshirë trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor në programin shkollor

5 komuna multi-etnike



Ngjarjet për Sigurinë Publike dhe Policinë në Komunitet, me 112 pjesëmarrës në 5 komuna, rezultuan në krijimin e një mekanizmi koordinues dhe komunikimi mes zyrtarëve komunalë, Policisë së Kosovës, përfaqësuesve të këshillave komunale të sigurisë, dhe qytetarëve

Mjedisi, Klima dhe Ripërtëritja nga Fatkeqësitë

Janë xhiruar **5 video**
klipe për të rritur
ndërgjegjësimin mbi rolin
e grave në menaxhimin e
fatkeqësive ne komunitet



Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë

11

11 zyrtarë të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent u trajnuan për softuerin “Geo-Information System” dhe për portalin “Geo-Portal”, për shkëmbim më të mirë të të dhënave dhe informacionit mes palëve lokale, regjionale dhe ndërkombëtare



7 komuna zhvilluan dokumentet e vlerësimit të rrezikut në nivel lokal duke përfshirë ndjeshmërinë gjinore, si dhe doracaku për ushtrimet në komunitet duke përfshirë ndjeshmërinë gjinore

360


U zbatuan 2 ushtrime në komunitet bashkërisht me Agjencinë për Menaxhim Emergjent, duke angazhuar drejtpërdrejt afërsisht 360 pjesëmarrës (38% gra dhe 62% burra)

16

16 komuna, duke përfshirë 4 komuna veriore, zhvilluan fushata ndërgjegjësimi në Ditën Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Shënimin e Ditës së numrit Evropian për emergjenca 112

38

U trajnuan 38 zyrtarë për çështje gjinore të komunave dhe të ministrive për vlerësimin e dëmeve pas fatkeqësisë në nivel lokal (69% gra dhe 31% burra)



3 komuna zhvilluan planin e reagimit komunal ndaj fatkeqësive duke përfshirë ndjeshmërinë gjinore;

38%
gra

62%
burra

31%
burra

69%
gra

Janë xhiruar **5 video klipe** për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin e grave në menaxhimin e fatkeqësive në komunitet

Reagimi Emergjent Ndaj Vërshimeve

107 pika në lumenj në regjionin e Mitrovicës u shënuan me shenja informuese për për llojin e rreziqeve

U hap një kanal mbrojtës në anë të rrugës në Pasjan të Parteshit, për mbrojtjen nga vërshimet

Mjetet dhe pajisjet për përgjigje ndaj vërshimeve u janë dhënë komunave të Mitrovicës, Mitrovicës së Veriut, Istogut, Skënderajt, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut



U rinovua ndërtesa e njësisë së zjarrfikësve në Leposaviq si nismë e krijimit të mirëbesimit ndërmjet komunës me popullatë jo shumicë dhe Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, dhe për bashkëpunim më të mirë me institucionet qendrore



Menaxhimi Ndërkufitar i Pellgut Lumor të Drinit

Projekti i parë i Kosovës me Fondin Global të Mjedisit (GEF), si pjesë e një projekti regjional



U themelua një grup punues ndërkufitar i ekspertëve të vërshimeve për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet

Për zhvillimin e analizës diagnostike ndërkufitare u prodhuan 6 raporte tematike në lidhje me ndotjen, mjedisin institucional dhe ligjor, biodiversitetin dhe ekosistemet, socio-ekonominë, hidrologjinë/hidrogjeologjinë dhe nyjen ujë-ushqim-energji-ekosisteme

U inicua një projekt demonstrues për trajtimin të ujërave të zeza në fshatin Kramovik dhe u përgatit raporti teknik i detajuar

Të dhënat, anketat dhe raportet

Pulsi Publik i Kosovës

Anketa e Pulsit Publik (që zhvillohet që nga viti 2002) intervistoi 1,300 qytetarë të Kosovës për të mbledhur të dhëna rreth pritshmërive të tyre për çështjet jetike

U ndërmor 1 anketë që për objektiv kishte mendimin e qytetarëve në komunat veriore të Kosovës



U përgatit 1 Dokument i Veprimit për temën “Marrëveshja e Brukselit për Drejtësinë: Pritjet dhe shqetësimet e qytetarëve të Kosovës së veriut”

U publikuan 2 përmbledhje të Pulsit Publik (në prill dhe tetor 2017)

U publikua një Analizë e Pulsit Publik mbi temën ‘Parandalimi të Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë’

36%

deklaruan të jenë të kënaqur me institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në Kosovë



Papunësia, çështja e sigurisë dhe varfëria u identifikuan si shqetësimet më të mëdha të qytetarëve të komunave veriore

77%
papunësia

38%
sigurisë

28.5%
varfëria

Anketa me Luftëtarët e Huaj në Kosovë

Anketa e parë e drejtpërdrejtë me luftëtarët e huaj të kthyer dhe familjet e tyre në Kosovë dhe rajon - 13 luftëtarë të huaj dhe pjesëtarët e familjeve të tyre

Anketa sqaron se nuk ka një rrugë të vetme drejt radikalizimit dhe profil specifik të personave të radikalizuar

Perceptimi i mundësive të kufizuara dhe cilësia e ulët e arsimit mund t'i ketë bërë kosovarët më të cenueshëm ndaj propagandës të grupeve ekstremiste

63% e të anketuarve besojnë se radikalizimi përbën kërcënim për komunitetin e tyre



Anketa në mbarë Kosovën – Rekomandimet në Nivelin e Komunitetit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë

608 

608 të anketuar dhe intervista në grupe fokusi për të mbledhur të dhëna të ndara sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor, statusit të punësimit, fesë dhe vendndodhjes gjeografike

63%

e të anketuarve besojnë se radikalizimi përbën kërcënim për komunitetin e tyre

20%

e të anketuarve deklaruan se e njohin një person të radikalizuar



Vetë-radikalizimi bëhet kryesisht përmes mediave online



Inovacioni

Luftimi i korrupsionit në mënyrë inovative

2 

U krijuan 2 lojëra për telefon mobil dhe u mbajt një konkurs vizatimor për fëmijë. Me 635 punime të dorëzuara, konkursi pati jehonë të madhe duke rritur ndërgjegjësimin në mes të rinjve mbi korrupsionin

15 

Punëtorja e Kuzhinës së të Dhënave i ktheu të dhënat e korrupsionit në diagramë të ngrënshëm: 15 pjesëmarrës përgatitën ushqime me receta vendore përmes të cilave prezantuan të dhënat mbi korrupsionin

U zhvillua aplikacioni i bazuar në ueb dhe mobil si një kanal i raportimit të vendit të hedhjes së mbeturinave dhe dëmtimit të infrastrukturës dhe tashmë janë marrë mbi 100 raportime nga qytetarët në komuna të ndryshme

Mbaje pastër – Qasja e përqendruar tek njeriu ndaj menaxhimit të mbeturinave

720

720 nxënës nga katër shkolla fillore kanë përmirësuar njohuritë e tyre për mbeturinat organike dhe jo-organike, për konceptin dhe procesin e riciklimit, dhe shkaqet e ndotjes dhe pasojat e saj, j përmes diskutimeve tërheqëse dhe sesioneve edukuese


5

U instaluan 5 kamera survejimi në katër ura dhe katër kulla në pikat e nxehta të qytetit të Gjakovës, për të parandaluar hedhjen e paligjshme të mbeturinave

Barazia Gjinore

31

Zyra e UNDP-së në Kosovës është një nga 31 zyrat e UNDP-së në mbarë botën, që vlerësohet për arritjen e rezultateve transformuese të barazisë gjinore dhe ka fituar Vulën e Argjendtë të UNDP-së për Barazinë Gjinore për periudhën 2015-2016



Integrimi gjinor është një komponentë e ndërthurur në të gjitha programet dhe procedurat e UNDP-së në Kosovë

50%

50% e përfituesve të përkrahjes për fuqizim ekonomik janë gra



Theks i veçantë në ripërtëritjen e grave ndaj reziqeve të fatkeqësive

United Nations Development
Programme in Kosovo

Zagrebi St. No. 58, 10000
Pristina, Kosovo,

Phone: +383 (0) 38 249066,

Fax: +383 (0) 38 249065,

E-mail:
registry.ks@undp.org

www.undp.org

